



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

KORRELACIONI NDËRMJET QEVERISJES SË KORPORATËS, MENAXHIMIT TË RREZIKUT DHE PERFORMANCËS SË BANKAVE

Artur Ribaj*, Klea Sinani*, Studente

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Albanian University

Abstrakti

Çfarë mund të ndikojë në performancën e një banke? Bazuar në analizën e literaturës e të dhënave nga hulumtimi për bankat, evidentojmë rëndësinë e respektimit të qeverisjes së korporatës, praktikave të mira të qeverisjes dhe menaxhimit efektiv të rrezikut. Këto kanë korrelacion pozitiv me performancën e bankës.

Rezultatet tregojnë se qeverisja e mirë duke vepruar vetëm në interes të aksionarëve mund të çojë në marrjen e tepër të rrezikut; në këtë kuptim, mund të ndodhë një konflikt interesi midis palëve të interesuara dhe aksionerëve, që përpiqen të maksimizojnë përfitimin e tyre. Mirëqeverisja dhe Manaxhimi rreziqeve mund të përforcohen nga Banka e Shqipërisë duke ndikuar në reduktimin e ekspozimit më të lartë ndaj rrezikut të bankave, përmes përmirësimit të kuadrit rregullator, dhe implementimin eficient të mbikëqyrjes, auditmit dhe masave macroprudenciale.

Fjalët kyçe: *Banka, Qeverisja e korporatave, Manaxhimi rrezikut, Performanca*

CORRELATION BETWEEN CORPORATE GOVERNANCE, RISK MANAGEMENT AND BANK PERFORMANCE

Abstract

What can affect the performance of a bank? The literature review and analysis of research data on banks generally emphasize the importance of compliance with corporate governance, good governance practices and effective risk management. These have a positive correlation with the bank's performance. It is interesting to see how these factors can shape the banking industry. The results show that good governance acting in the interests of shareholders can lead to excessive risk taking; in this sense, a conflict of interest may occur between stakeholders and shareholders, who try to maximize their benefit. Good governance and risk management can be strengthened by the Bank of Albania by influencing the reduction of the higher exposure to banks' risk, through enhancing banking regulations and the efficient implementation of supervision, audit and macroprudential measures.

Keywords: *Bank, Corporate Governance, Risk Management, Performance*

1. Hyrje

Kriza financiare e vitit 2008 goditi SHBA, dhe në vitin 2009-2010 e në vijim u përhap ne tregjet financiare të vendeve të tjera pasi ato janë të integruara përmes investimeve dhe transaksioneve financiare. Shqipëria gjithashtu pati efekte goditëse nga kjo krizë e cila preku vendet fqinje me të cilat Shqipëria ka marrëdhënie tregtare por edhe investime të bankave të tyre në kapitalin e disa bankave tregtare në Shqipëri. Për shkak të kësaj krize, disa biznese falimentuan, disa biznese u përballën me vështirësi financiare, disa të tjera u detyruan të ndryshojnë pronësinë. Në kohë krize është shumë e vështirë të konvertosh borxhin në aksione të zakonshme. Sektori bankar si një nga aktorët kryesorë në stabilitetin financiar të vendit, në rast krize besimi e kërkon gjithomë zgjidhjen nga shteti/qeveria për daljen nga kriza. Qeveria investon shumën të mëdha në sektorin bankar për të mbrojtur paratë e depozituesve dhe për t'i shpëtuar ato nga falimentimi. Pse qeveria i jep më shumë prioritet sektorit bankar se të tjerët? Ka disa arsye: Depozituesit e një banke nuk mund të vet-mbrohen sepse nuk kanë informacion të mjaftueshëm, ose informacioni është asimetrik, ose kanë mungesë të edukimit financiar, etj; Asetet e bankës janë çuditërisht jo të qarta dhe ju mungon transparenca si dhe likuiditeti; Pasiguria e një banke do të ndikojë në gjithë sistemin financiar dhe ekonominë e vendit.

Qeverisja e korporatave është shumë e rëndësishme për zhvillimin financiar. Me krizën e fundit financiare, shumë vende në zhvillim e ndiejnë rëndësinë e qeverisjes së korporatave. Për këtë qëllim në vitin 1999 OECD vendosi parimin e qeverisjes së korporatave. Qeverisja e korporatave është shumë e rëndësishme për sektorin bankar sepse sektori bankar është i lidhur me zhvillimin dhe stabilitetin makroekonomik të Shqipërisë. Prandaj, Banka e Shqipërisë ka detyrime ligjore dhe ka miratuar akte rregullatore për bankat tregtare lidhur me mirë qeverisjen, kontrollin e auditimit të tyre. Zhvillimi i sektorit bankar mund të matet me qeverisjen e korporatave. Gjithashtu, AMF ka miratuar akte rregullatore për qeverisjen e korporatës në shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e administrimit të fondeve të pensionit apo investimeve, bursës, etj. Këto janë hapa të rëndësishëm për të reformuar rregullat e qeverisjes së korporatës. Fushat kryesore të këtyre rregullave janë bordi i drejtorëve, i cili është përgjegjës për të gjithë aksionarët. Ai përfshin gjithashtu audituesin e brendshëm dhe të jashtëm, menaxhimin e rrezikut dhe politikën e bordit. Objektivi kryesor i këtij kodi është transparenca më e mirë dhe mbrojtja e interesave të aksionerëve. Praktika e mirë e qeverisjes së korporatës do të çojë në vlerë të lartë të bankës, produktivitet të lartë dhe rrezik më të ulët. Qeverisja e mirë është relativisht fitimprurëse dhe e çmuar për firmën dhe firma i jep më shumë para aksionerit në afatgjatë. Në vitet e fundit, qeverisja e korporatave është bërë një fushë e rëndësishme kërkimore. Ekziston një lidhje pozitive midis nivelit të qeverisjes së korporatës dhe performancës së bankës.

Mekanizmat e qeverisjes së korporatës i japin garanci aksionerit se menaxheri do të performojë në interesin e tyre. Qeverisja e korporatës është mënyra me të cilën investitorët financiar sigurojnë se do të fitojnë një kthim në emër të investimit të tyre nëse banka mund të menaxhojë me saktësi fondet e investitorëve. Në sektorin bankar duhet të ketë një shqyrtim shumë të kujdesshëm të qeverisjes së korporatave, sepse bankat duhet të krijojnë besim, pasi kështu mund të tërheqin më shumë depozitues dhe investitorë/aksionarë.

2. Metodologjia

Metodologjia e punimit është gërshetimi midis metodave sasiore dhe metodave cilësore të kërkimit. Pavarësia e bordit, madhësia e bordit, CEO dhe komiteti i auditimit përdoren si variabla për qeverisjen e korporatës, ndërsa variablat e rremë përdoren për performancën e bankës. Metodologjia e këtij punimi bazohet në kuadrin konceptual të studimit që shpjegon lidhjen e qeverisjes së korporatave, menaxhimit të rrezikut dhe performancës së bankës. Qeverisja korporative duket e vështirë për tu aplikuar me vullnetin e lirë të bankave për shkak të problemit të agjencisë dhe informacionit asimetrik

që aplikojnë, pasi supozon: aksionerët e bankës janë të lidhur me maksimizimin e pasurisë së tyre dhe kthimin e investimit në bankë; drejtuesit e bankës janë të prirur ndaj rrezikut.

Metodologjia e punimit është gërshetimi midis metodave sasiore dhe metodave cilësore të kërkimit. Punimi bazohet në përshkrimin e fakteve të ndryshme që lidhen me Qeverisjen e Korporatave, Menaxhimin e Riskut dhe Performancën e Bankes. Një peshë të madhe të punimit e zënë informacionet e përpunuara nga literatura ndërkombëtare mbi fushën bankare. Në këtë punim informacionet janë marrë edhe nga bibliotekat elektronike të universiteteve të ndryshme si dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Burim tjetër dhe shumë i vlefshëm janë edhe materialet e marra nga kërkimet shkencore, revistat shkencore. Hulumtimi është i natyrës përshkruuese sepse është përshkruar qeverisja e korporatës, menaxhimi i rrezikut, performanca e bankës dhe lloji i pronësisë. Në këtë studim është hulumtuar edhe marrëdhënia shkak-pasojë e qeverisjes së korporatave me strukturën e pronësisë së bankës. Pa diskutim që punimi ka edhe kufizimet e veta, diktuar nga fakti kohë nuk është siguruar një bazë e mjaftueshme e të anketuarve për analizën e të dhënave. Jemi të ndërgjegjshëm se ka vend për zgjerime dhe përmirësime të mëtejshme, por e konsiderojmë këtë punim një hap solid në analizimin e njëres prej temave më të rëndësishme të sektorit bankar.

3. Shqyrtimi i literaturës

Ciancanelli dhe Gonzales (2000) argumentojnë se strukturat e tregut të bankave ndryshojnë, dhe ata vënë në pikëpyetje supozimet bazë të teorisë së agjencisë. Ata besojnë se menaxherët dhe pronarët e bankave fokusohen më shumë në rregulloret që i shërbejnë interesit publik, që përfaqëson qeverisjen e jashtme të korporatës. Pronarët gjithashtu kanë prioritet menaxhimin e rreziqeve bankare dhe maksimizimin e kthimeve për të siguruar që investimi i tyre të jetë i frytshëm. Ndarja e pronësisë dhe kontrollit krijon probleme të brendshme të qeverisjes së korporatës. Menaxherët dhe punonjësit mund t'i japin përparësi interesave të tyre personale, të cilat mund të bien ndesh me interesat e konsumatorëve, duke çuar në probleme të agjencisë. Për të adresuar këtë, pronarët e bankave duhet të ofrojnë kompensim dhe stimuj për menaxherët bazuar në interesat kolektive të bankës. Zgjedhja e një bordi drejtorësh që mund të punojë për interesat e përbashkëta të bankës është vendimtare. Ky mekanizëm bie nën qeverisjen e brendshme të korporatës, ku pronari pret që menaxheri të veprojë në interesin më të mirë të bankës.

Problemi i brendshëm i qeverisjes së korporatës krijohet nga ndarja e pronësisë dhe kontrollit nga menaxhimi, pasi mendohet se menaxherët luftojnë për interesat e tyre vetjake dhe jo për interesat e aksionerëve. Nëse pronari i bankës i jep kompensim dhe nxitje për menaxherët vetëm atëherë ai do të punojë për interesat kolektive të bankës dhe problemet e agjencisë do të zgjidhen. Pronari i bankës duhet ta zgjedhë anëtarë në bordin e drejtorëve vetëm ata që kanë aftësi të punojnë për interesat e përbashkëta të bankës. Ky mekanizëm do të ketë të bëjë me qeverisjen e brendshme të korporatës, sipas kësaj, pronari duhet të presë që menaxheri të punojë për të njëjtin qëllim dhe të njëjtin drejtim. Por shpesh pronari (aksionerët) i bankës është i interesuar për fitimin e bankës me qëllim rritjen e kthimit nga investimi (ROE); prandaj pronari bankës bën më shumë presion menaxherëve që banka të ndërmarrë veprimtari me rreziqe për të siguruar fitime të larta. Lidhja e qeverisjes së korporatave me performancën e bankave është e ndryshme. (La Porta et al., 2002) ka llogaritur se nëse performanca e një firme është e lartë, atëherë aksionari do të jetë i mbrojtur. (Klapper & Love, 2002) deklaruan se qeverisja e mirë e korporatës ka lidhje pozitive me performancën më të mirë të aktivitetit financiar. (Black et al., 2003) dhe (Drobetz et al., 2003) argumentojnë se ekziston një lidhje optimiste midis qeverisjes së korporatave dhe performancës. Ata gjithashtu rekomandojnë që, nëse banka mund të miratojë rregulla të mira të qeverisjes së korporatës vlera e aktivitetit të saj do të rritet për lartë. Lloji i pronësisë së bankës ka një marrëdhënie të arsyeshme ndërmjet qeverisjes së korporatës, menaxhimit të riskut dhe performancës së bankës. Struktura e saj mund të jetë ndarë në bazë të pushtetit

dhe kontrollit. Pronari kryesor ka një autoritet për të kontrolluar dhe zgjedhur menaxhimin (Patrick, 2001). Lloji i pronësisë së bankës mund të klasifikohen në bazë të bankave private, bankave publike dhe bankat me pronësi të huaj. (Deutsch & Pinter, 2018) llogariten se ekziston një lidhje jokonstruktive ndërmjet performancës dhe përqendrimit të pronësisë. Këto studime janë të lidhura edhe me menaxhimin e efikasitetit të bankave me pronësi private kundrejt bankave me pronësi shtetërore. (Mester, 1993) deklaroi se bankat në pronësi publike kanë një avantazh të vogël fitimi dhe kostoje ndaj bankave private. (Altunbas et al., 2001) raportoi se bankat private janë më kompetente se bankat shtetërore. (O'Hara, 1981) sugjeroi se mbikëqyrja e bankave shtetërore është më e vogël përkundrejt mbikëqyrjes së bankave private.

(Claessens & Fan, 2003) analizojnë se problemi i agjencisë u ngrit për shkak të strukturës së pronësisë. Mekanizmat e qeverisjes së korporatave nuk mjaftojnë vetëm për të reduktuar këtë problem por firmat aplikojnë mekanizma shtesë për ta ulur atë, sepse firmat aplikojnë sisteme të mira audituese. Teoritë për sistemin e kapitalizmit kanë treguar se përfshirja e qeverisë në pronësinë e bankave dhe mekanizmat e dobët të qeverisjes së korporatave nuk janë të rrezikshme vetëm për investitorët, por ato janë të rrezikshme edhe për performancën e bankës dhe në përgjithësi rritjen ekonomike të vendit. Teoria e agjencisë parashikon që konflikti ndërmjet menaxherit dhe aksionarit mund të prishë vlerën e bankës. Teoria e agjencisë deklaron se konflikti i interesit ndërmjet menaxherit dhe pronarit krijohen nga ndarja e pronësisë. Por, në varësi të strukturës së pronësisë do të kishim zvogëlim të konfliktit ndërmjet menaxherit dhe pronarit. Në rast se menaxheri zotëron aksione (të drejtë pronësie) në një bankë do të ishte e përshtatshme edhe për aksionerët e tjerë sepse nuk ka hendek midis interesit të menaxherit dhe aksionerëve teoria e agjencisë). Gjithashtu, niveli i shpërndarjes së pronësisë luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e Qeverisjes së mirë të korporatës, shpërndarja e pronësisë zvogëlon problemet e agjencisë. Sa më e gjerë të jetë baza e aksionerëve aq më e përshtatshme do të jetë ajo edhe për mirë qeverisjen.

Problemi i agjencisë në sektorin bankar. Problemi i agjencisë mund të fillojë me ndarjen e pronësisë dhe menaxhimit kur menaxheri punon për interesin vetjak jo për interesin e pronarit. Bankat kanë një sërë mekanizmash për të kontrolluar menaxhimin në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre. Sipas teorisë së agjencisë (Jensen dhe Meckling, 1976), menaxherët pritet të jenë më pak të gatshëm për të marrë rreziqe sepse ata mund të kujdesen më shumë për reputacionin e tyre dhe sigurinë e punës (Angkinand dhe Wihlborg, 2010). Bankat zakonisht miratojnë një SOG¹. Kjo nënkupton që objektivat e aksionerëve kanë një ndikim të madh në stimujt e menaxherëve dhe strukturat e tyre përpiqen të mbrojnë interesat e aksionerëve (Srivastav dhe Hagendorff, 2016; Orozco et al., 2018). Si rezultat, nëse qeverisja e bankës është e orientuar nga aksionerët, pritet që kompania të pranojë një nivel më të lartë rreziku për të maksimizuar fitimet dhe kthimet. Por përafrimi i interesave ndërmjet menaxherëve dhe aksionerëve mund të rezultojë në marrjen e rrezikut më të lartë në kurriz të depozituesve, kreditorëve dhe tatimpaguesve. (Bhattacharya, Boot, & Thakur, 1998) argumentoi se menaxheri dhe pronari janë të dështuar për të kontrolluar strukturën e tregut të jashtëm të bankës. Për këtë arsye qeveria luan rol për të kontrolluar strukturën e tregut të jashtëm të bankës për arsye të ndryshme. Sektori bankar luan një rol shumë jetik në stabilitetin e sistemit financiar të vendit. Stabiliteti dhe paqëndrueshmëria do të ndikojnë në të mirën dhe të keqen ekonomike dhe të sistemit financiare të një vendi. Sektori bankar i një vendi përdoret si mjet për të mbështetur industri të caktuara. Në sektorin bankar mjedisi konkurrues është më pak sfidues se sektorë të tjerë të ekonomisë (Llewellyn & Sinha, 2000). *Nëse një biznes ka një menaxhim jo të mirë do të dalë shpejt nga tregu, por nëse një bankë ka një menaxhim jo të mirë, ajo do të konkurrojë bankat e tjera dhe do të infektojë edhe bankat e tjera derisa të dalë nga tregu.* Gjithashtu, sektori bankar ka mjedis më pak konkurrues në krahasim me bizneset nga industritë e tjera sepse informacioni në bankë ruhet konfidencialisht (Barth et al., 2001). (Shleifer & Vishny, 1997) deklaruan se stadi i përhapjes të së drejtës ka një ndikim të fortë në

¹ Statement of Guidance on Corporate Governance for Mutual Funds and Private Funds (Deklaratë e Udhëzuesit për Qeverisjen e Korporatave për Fondet e Përbashkëta dhe Fondet Private)

instrumentin e qeverisjes së korporatës. Ata gjithashtu sugjerojnë se shpenzimet për opinionet apo mendimet dhe problemi i udhëtarit pa pagesë² janë të lidhura me nivelin e koncentrimit të pronësisë. Koncentrimi i pronësisë do të thotë që aksioneri ka më shumë fuqi për të kontrolluar menaxherin. Prandaj struktura e pronësisë luan një rol shumë të rëndësishëm në mekanizmin e qeverisjes korporative. Investitorët zgjedhin portofolin efikas që jep një kthim më të lartë me një nivel parashikimi të rrezikut. Prandaj tregon se ka një marrëdhënie reciproke mes rrezikut dhe kthimit në investime. Funksionimi i qeverisjes korporative në sektorin bankar është i ndryshëm në krahasim me sektorët e tjerë. (Macey & O'hara, 2003) deklaruan se në sektorin bankar duhet të ketë një kujdes më të madh për qeverisjen korporative, sepse mekanizmat e qeverisjes së korporatave në banka duhet të rrisin besimin dhe të tërheqin më shumë depozitues dhe aksionarë.

3.1 Mekanizmat e jashtëm dhe të brendshëm të Qeverisjes së Korporatës

Përgjithësisht, besimi i depozituesve për paratë që vendosin në depozita pranë bankave në Shqipëri është për shkak të sigurisë apo garancive që ata kanë nga shteti (qeveria). Bankat tërheqin më shumë depozitues për të depozituar paratë e tyre në bankë sepse ata besojnë që koston e rrezikut moral e kanë të garantuar nga qeveria. Nëse qeveria vijon të ofrojë mbështetje pa kufi për sigurimin e depozitave, drejtuesit e bankës mund të motivohen të rrisin marrjen e rrezikut për investimin e këtyre depozitave, duke mos menduar për shpenzimet e qeverisë në rast se do të jenë në paaftësi likuidimi të depozitave për shkak të ekspozimit të madh në rrezik të investimit të bankës. Për këtë, BSH ka kuadër rregullator për zbatim nga bankat. Por, zbatimi i kërkesave rregullatore duhet të monitorohet dhe auditohet nga strukturat qeverisëse brenda bankës, pa pritur derisa të vijnë inspektorët e BSH për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Për këtë qëllim, sektori bankar kërkon jo vetëm përfshirjen e BSH (mbikëqyrësit) por së pari ka nevojë për mekanizma të mirë të qeverisjes së korporatës brenda bankës. Qeveria i garanton depozituesit që do të kompensojë kursimet e tyre nëse banka shkon drejt falimentimit. Por, procedura e kompensimit nga qeveria (ASD) kërkon shumë kohë dhe gjatë kësaj kohe depozituesi humbet vlerën e parasë përmes inflacionit dhe mundësinë e investimit nëse do të kishte paratë. Prandaj ata zgjedhin atë bankë e cila mund të menaxhojë në mënyrë efikase paratë e depozituesit. Për këtë arsye, depozituesi jo vetëm që beson në mekanizmat e jashtëm të qeverisjes së korporatës, por ata e dinë që menaxheri i bankës mund të zbatojë mekanizma të mirë të qeverisjes korporative në bankë. Ana e brendshme është më e rëndësishme se ajo e jashtme. Mekanizmat e brendshëm të qeverisjes së korporatës lidhen me auditimin dhe manaxhimin e rreziqeve të bankës. Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i bankës kanë përgjegjësinë kryesore për zbatimin e rregullave të mira të qeverisjes së korporatës. Struktura, funksioni, aktiviteti dhe kompensimi janë përgjegjësi e bordit të drejtorëve. Gjithashtu, në literaturë vendoset theksi mbi rregullimin dhe ruajtjen e tërësisë së sistemit bankar për gjithë tregun dhe jo vetëm një bankë. Sot, dhe sidomos pas krizës së vitit 2008, i kushtohet më shumë vëmendje funksionit të autoriteteve rregullatore e mbikëqyrëse (BSH, AMF) për sektorin financiar, pasi ato janë rregullues dhe mbikëqyrës të sektorit financiar dhe ruajtjes së stabilitetit financiar. (Ciancanelli & Gonzales, 2000) argumentojnë se autoritetet rregullatore/mbikëqyrëse simbolizojnë mekanizmat e jashtëm të qeverisjes korporative.

Teorikisht, depozituesit duhet të zgjedhin atë bankë e cila mund të menaxhojë në mënyrë efikase paratë e tyre. Praktikisht, depozituesit nuk janë në gjendje të bëjnë këtë analizë. Ata kanë besim në mekanizmat e jashtëm të qeverisjes së korporatave, dhe garancinë se BSH dhe AMF do të kontrollojnë edhe drejtuesit e bankës për apikimin e mekanizmave të mirë të qeverisjes korporative në bankë. Në parimet e qeverisjes, mekanizmat e brendshme janë më shumë të rëndësishme se ato të jashtme. Mekanizmat e brendshëm të qeverisjes së korporatës janë të lidhura për të kontrolluar dhe monitoruar bankën (Llewellyn & Sinha, 2000). Bordi drejtues dhe menaxhmenti i bankës kanë përgjegjësinë kryesore për të zbatuar rregullat e mira të qeverisjes së korporatës. (Nam, 2004) deklaroi se struktura,

² the free-rider problem occurs when an individual or group of individuals improperly gain from some third party act or product or decision without having to pay for it.

funksioni, veprimtaria dhe kompensimi janë përgjegjësi e bordit drejtues të bankës.

3.2. Qeverisja e Korporatës dhe Performanca e Bankës.

Për rritjen e besueshmërisë së tregut, pronari dhe menaxheri i bankës i kushtojnë më shumë fokus aplikimit të qeverisjes së mirë korporative. Kështu ata mund të grumbullojnë depozita/ fonde me kosto më të ulët dhe rrezik më të vogël, prandaj qeverisja e mirë do të çojë në performancë të lartë. Disa studime të mëparshme e mbështesin këtë deklaratë. Performanca financiare e bankës dhe qeverisja korporatës janë të lidhura pozitivisht pra nëse banka mund të zbatojë rregulla të mira të qeverisjes së korporatës, performanca e asaj firme do të jetë e lartë. Nëse një aksioner është i mbrojtur mirë, performanca e firmës do të jetë e lartë. Nëse një bankë mund të zbatojë rregulla të mira të qeverisjes së korporatës, performanca do të jetë e lartë, kështu që qeverisja e korporatës është e ndërlidhur pozitivisht me performancën e bankës, gjithashtu arrijmë në perfundimin se qeverisja e korporatës është shumë e rëndësishme për atë vend i cili ka një mjedis të dobët ligjor.

Marrëdhënia midis Performancës së Bankës dhe Menaxhimit të Riskut. Zbatimi i qeverisjes së mirë të korporatës varet nga administrimi i rrezikut dhe performanca e bankës. Nëse banka mund të menaxhojë rrezikun siç duhet, ajo do të përfitojë nga rritja e kthimit nga investimi dhe kthimi tregon performancën e bankës duke ndikuar edhe në rritjen e vlerës së aksioneve të bankës. Menaxhimi më i mirë i rrezikut tregon se banka mund të operojë aktivitetet e saj me rrezik më të ulët dhe konflikt më të ulët interesi ndërmjet palëve. Performanca më e mirë e bankës rrit reputacionin e saj në sytë e publikut. Ata tërheqin më shumë aksionarë dhe mbledhin një fond të madh me kosto më të ulët, kështu banka ka mundësi të rrisë produktivitetin e saj dhe të vijojë me rritjen e kthimit nga investimi aksionerëve. Ekziston një lidhje jokonstruktive e rastësishme midis fitimit të bankës dhe menaxhimit të rrezikut. Mekanizmi i menaxhimit të rrezikut rrit performancën e bankës, por jo domosdoshmërisht fitimin. Pra, ekziston një ndërlidhje negative midis menaxhimit të rrezikut dhe fitimit të bankës në afatshkurtër.

3.3 Struktura e pronësisë si një përcaktues kryesor i menaxhimit të rrezikut.

Sipas teorisë së Agjencisë, niveli i shpërndarjes së pronësisë luan një rol jetik në menaxhimin e riskut të bankës. Hulumtimi evidenton se forma aksionare e përqendruar ka më shumë dore të lira për të kontrolluar bankën në krahasim me një bankë që zotërohet nga një bazë e shpërndarë (e gjerë) e aksionerëve (tipikisht rasti bankave me kapital vendas në Shqipëri, të cilat zotërohen në maxhorancë nga një aksioner i vetëm). Ekziston një lidhje midis strukturës së pronësisë dhe menaxhimit të rrezikut. Besueshmëria e bankës rrit besimin e investitorit më shumë tek depozituesi dhe investitori, të cilët depozitojnë fondet e tyre në bankë. Besimi klientit (depozitues, investitor) i qëndrueshëm dhe afatgjatë është jashtëzakonisht i rëndësishëm për bankat. Banka fondet e grumbulluara i jep kredi me afat dhe në rast se depozitues e investitor tërheqin fondet e tyre, banka nuk ka çfarë të bëjë përveç se të shkojë drejt falimentimit. Për më tepër, mungesa e informacionit dhe marrëdhëniet delikate të besimit në biznesin bankar ngrenë vetëdijen e klientëve për të mos zgjedhur një bankë të komentuar negativisht për të investuar fondet e tyre, prandaj banka e shëndoshë me qeverisje të mirë korporative akumulon më shumë para me kosto dhe rrezik më të ulët. Marrëdhënia ndërmjet strukturës së pronësisë, qeverisjes së korporatës dhe menaxhimit të rrezikut është më e ndjeshme për performancën e bankës.

Marrëdhënia ndërmjet Llojit të pronësisë së bankës, performances së bankës dhe menaxhimit të rrezikut. Disa nga bankat janë të ngjashme në llojin dhe strukturën, por disa janë të ndryshme. Lloji dhe statuti i bankës shpjegojnë palët kontrolluese të bankës. Aksionari mund të jetë kontrolli në bazë të strukturës së pronësisë së bankës. *Ndërsa lloji i pronësisë së bankës lidhet me kulturën organizative siç janë bankat private, shtetërore dhe të huaja.* Kultura, qëndrimi dhe sjellja e këtyre tre llojeve të bankave janë të ndryshme, kështu që natyra e menaxhimit të kësaj banke është e ndryshme dhe gjithashtu sjellja dhe performanca e rrezikut të këtyre bankave. Banka me kapital privat e menaxhuar

nga afër me kujdes ka performancë financiare (fitim) më të mirë se banka në pronësi publike. Bankat me kapital shtetëror (publike) performojnë dobët sepse kanë mungesë të kontrollit (auditimit) të menaxhimit për shkak të ndërhyrjeve politike, etj. Sipas teorisë së agjencisë, ekziston një lidhje midis strukturës së pronësisë dhe performancës financiare. Auditimi dhe kontrolli e bëjnë bankën me kapital privat më efikase sesa banka në pronësi publike. Problemi i agjencisë së bankës me kapital privat është lëvizja nga konflikti i menaxherit kundër pronarit dhe depozituesve. Problemi i agjencisë fillon në sektorin bankar në atë kohë kur interesi i menaxherit të bankës është i kundërt me rregulloret e qeverisjes korporative. Aksionerët privatë dëshirojnë që menaxheri të marrë më shumë rrezik, prandaj ata inkurajojnë menaxherin të japë stimuj dhe kompensim për të marrë më shumë rrezik. Por rregullatorët e bankës duan që menaxheri të marrë më pak rrezik për stabilitetin e sistemit financiar. Prandaj ata dekurajojnë menaxherin se skema e kompensimit është shumë e rrezikshme për bankën. Në disa ekonomi në zhvillim, qeverisja korporative e bankës në pronësi shtetërore (publike) është më komplekse kur përfshirja politike operon në sistemin bankar. Në bankën shtetërore (publike), ndërprerja e përplasjes mes depozituesit dhe menaxherit varet nga besueshmëria e qeverisë. Kur në një ekonomi të gjerë të bankës shtetërore mund të lindë problemi i qeverisjes së korporatave, atëherë fillojnë edhe divergjenca mes administratës dhe taksapaguesve, menaxherëve dhe burokratëve. Ndodh për menaxherët e bankave me kapital shtetëror, të cilët kanë profil politik apo lidhje të ngushta politike, ata nuk punojnë për interesin e tatimpaguesit, por janë më të përqëndruar në përmirësimin (investimin) e tyre në aspektin politik. Ndryshe ndodh për menaxherët jo-politikë të bankave me kapital shtetëror, ata janë më pak të prirur ndaj rritjes së fitimit të bankës përmes investimeve me rrezik të lartë, ndryshe nga menaxherët e bankave me kapital privat, të cilët të nxitur nga aksionerët pranojnë më shumë rrezik në menaxhimin e portofolit të tyre. Banka me kapital shtetëror luan një rol të rëndësishëm në shumë sektorë ekonomikë ashtu si bujqësia dhe sipërmarrjet e vogla të mesme, të cilat nuk financohen apo financohen me kosto shumë të lartë nga bankat me kapital privatë.

4. Analizë empirike

Çfarë ndikon në qeverisjen e mirë të një banke?


22 responses



Bazuar në të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorit në lidhje me Qeverisjen e Korporates, Menaxhimin e Riskut dhe Performancën e Bankës.

Cili është ndikimi i qeverisjes së korporatës në menaxhimin e rrezikut?

22 responses




86.4% e personave kane zgjedhur alternativën që për një qeverisje të mire të një banke ndikojnë disa faktorë. Një strukturë drejtuese e organizuar mire është thelbësore për qeverisjen e mire të një banke. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që drejtuesit e bankës të jenë profesionist pra të kenë njohuri në fushën financiare, menaxheriale dhe ligjore si dhe të kenë një lidhje të fortë me auditimin.

100% mendojnë që qeverisja e korporatës ka një ndikim të rëndësishëm në menaxhimin e rrezikut në një kompani. Një qeverisje e mirë korporative siguron transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të përcaktuar për menaxhimin e rrezikut. Kjo ndihmon në zvogëlimin e rrezikut dhe në rritjen e besimit të investitorëve dhe palëve të interesuara.

Sa ndikon struktura aksionere në qeverisjen e një banke?


22 responses



95.5% e personave mendojnë se struktura aksionere ka një ndikim të rëndësishëm në qeverisjen e bankës. Një strukturë e aksionerëve të diversifikuar dhe të pavarur mund të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe pavarësisë së bankës.

Ku mendoni qe ka me shume besim nje depozitues, tek nje banke me kapital shtetedor apo tek nje banke me kapital privat?

22 responses



81.8% e personave kane zgjedhur alternativen “Tek nje banke me kapital shtetedor”, pasi kanë më shumë besim te një bankë me kapital shtetëror. Bankat me kapital shtetëror mund të japë një ndjenjë të sigurisë dhe mbështetjes së qeverisë për bankën.

Nga çfare varet besimi i depozituesve sipas mendimit tuaj?


22 responses



63.6% e personave mendojne se besimi i depozituesve varet nga siguria qe te jep nje banke me kapital shtetedor. Teorikisht, përse i perket besimit te depozituesve të bankës, kjo varet nga reputacioni dhe performanca e bankes, pavaresisht nga pronësia shtet apo privat i kapitalit të bankës.

Kur mendoni qe ka me shume risk banka, kur kemi pronesi familjare apo aksionere te listuar ne bursë?

22 responses



63.6% mendojnë se bankat me pronesi familjare kanë më shumë potencial për risk se ato me aksionerë të listuar në bursë. Kjo sepse në bankat me pronësi familjare si vendimi i zgjedhjes së bordit drejtues merret nga një grup i ngushtë individësh, pa përfshirë një numër të gjerë aksionerësh të tjerë. Kjo mund të rezultojë në mungesë të pavarësisë së vendimeve dhe mungesë të transparencës në procesin e vendimmarrjes me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre private duke rrezikuar sigurinë e depozituesve dhe stabilitetin financiar të Shqipërisë.

Kur është më i ulët risku, kur kemi një grup me shumë aksionere apo me pak?


22 responses



Pjesa më e madhe e personave mendojnë se risku është më i ulët kur kemi një grup me shumë aksionere. Sa më e gjere baza e aksionereve aq më solide dhe e konsoliduar është struktura e qeverisjes së korporatave në bankë dhe aq më i ulët është risku.

Një qeverisje e mirë e korporatave:

22 responses



95.5% e personave kanë zgjedhur alternativën e cila përmbledh disa tregues cilësor. Një qeverisje e mirë e korporatave përmirëson performancën financiare, ndihmon në arritjen e qëllimeve të bankës dhe promovon transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë e menaxhmentit. Kështu sigurohet një bazë e qëndrueshme për rritjen dhe suksesin e një banke.

A është thelbësore qeverisja e korporatave për performancën dhe qëndrueshmërinë e bankave në treg?


22 responses



Të gjithë e kuptojnë se qeverisja e korporatave është thelbësore për performancën dhe qëndrueshmërinë e bankave në treg. Një strukturë e mirë e qeverisjes së korporatave ndihmon në rritjen e besimit të investitorëve, në parandalimin e konflikteve të interesave dhe në sigurimin e transparencës së informacionit. Kjo mund të çojë në rezultate më të mira për bankën në aspektin financiar dhe operacional.

Disa prej strukturave të qeverisjes së korporatave që ndikojnë në menaxhimin e riskut dhe performancën e bankës janë:

22 responses



95.5% kanë zgjedhur alternativën e cila përmbledh disa cilësime të trajtuara gjatë punimit. Një pjesë shumë e vogël mendon ndryshe. Disa prej strukturave të qeverisjes së korporatave që ndikojnë në menaxhimin e riskut dhe performancën e bankës janë ato që janë përmendur më lart. Këto struktura të qeverisjes së korporatave kanë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e rrezikut dhe performancën e bankës, duke siguruar që rreziqet të identifikohen, vlerësohen dhe menaxhohen në mënyrë efektive.

5. Konkluzione

Ky studim ka nxjerrë në pah tre aspekte të qeverisjes së korporatës, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut, performancën e bankës dhe strukturën e pronësisë. Analiza ka evidentuar se ka një ndërlidhje brenda këtyre tre aspekteve të qeverisjes së korporatës, si në vijim:

- Struktura e pronësisë konsiderohet si një element kryesor i menaxhimit të rrezikut.

- Menaxhimi efektiv i rrezikut në bankë mundësohet kur aplikohet qeverisja e mirë e korporatës e cila realizon edhe një performancë financiare më të mirë të bankës.
- Marrëdhëniet ndërmjet qeverisjes së korporatës me strukturën e pronësisë dhe menaxhimit të rrezikut janë vendimtare për performancën e bankës.

Përmes aplikimit të qeverisjes së mirë në banka dhe mbikëqyrjes së tyre nga BSH për nivelin e aplikimit bazuar në parimet dhe praktikën e mira të qeverisjes do të përfitojnë vet bankat, aksionerët, punonjësit dhe klientët e tyre, qeveria dhe shumë pretendentë të tjerë.

Referencat

1. Altunbas, Y., Evans, L., & Molyneux, P. (2001). Bank Ownership and Efficiency. *Journal of Money, Credit and Banking*, 33, 926-954. <https://doi.org/10.2307/2673929>.
2. Barth, J. R., Caprio, G., & Levine, R. (2001). *The Regulation and Supervision of Banks around the World: A New Database* (Vol. 2588). World Bank Publications. <https://doi.org/10.1353/pfs.2001.0003>
3. Bhattacharya, S., Boot, A. W., & Thakor, A. V. (1998). The Economics of Bank Regulation. *Journal of Money, Credit and Banking*, 30, 745-770. <https://doi.org/10.2307/2601127>
4. Black, B. S., Jang, H., & Kim, W. (2003). Does Corporate Governance Affect Firm Value? Evidence from Korea. Bachelor Thesis, University of Chicago Law School, Law and Economics Workshop. <http://arno.uvt.nl/show.cgi?fid=61459>
5. Bonin, J., Hasan, I., & Wachtel, P. (2003, November). Privatization Matters: Bank Performance in Transition Countries. *Journal of Banking and Finance*, 29, 2155-2178. <https://doi.org/10.2139/ssrn.542722>
6. Boot, A. W., & Thakor, A. V. (1993). Self-Interested Bank Regulation. *The American Economic Review*, 83, 206-212.
7. Brown, L. D., & Caylor, M. L. (2004). *Corporate Governance and Firm Performance*.
8. Deutsch, N., & Pintér, É. (2018). The Link between Corporate Social Responsibility and Financial Performance in the Hungarian Banking Sector in the Years Following the Global Crisis. *Financial and Economic Review*, 17, 124-145. <https://doi.org/10.25201/FER.17.2.124145>
9. Drobetz, W., Schillhofer, A., & Zimmermann, H. (2003). Corporate Governance and Firm Performance: Evidence from Germany. Unpublished Working Paper, University of Basel. <https://doi.org/10.2139/ssrn.369100>
10. Goldberg, L. S., Dages, B. G., & Kinney, D. (2000). Foreign and Domestic Bank Participation in Emerging Markets: Lessons from Mexico and Argentina. <https://doi.org/10.3386/w7714>
11. Havrylchyk, O. (2003). Efficiency of the Polish Banking Industry: Foreign versus National Banks. Paper for 24th SUERF Colloquium, Tallinn, 12-14 June 2003, 1975-1996. <https://doi.org/10.2139/ssrn.499922>
12. Javid, A. Y., & Iqbal, R. (2010). *Corporate Governance in Pakistan: Corporate Valuation, Owner-*

ship and Financing. Working Papers & Research Reports.

13. Jensen, M., & Mackling, W. H. (1976). Theory of the Firm: Managerial Behavior, Agency Cost and Ownership Structure. *Journal of Financial and Quantitative Analysis*, 27, 247-263.
14. Jorion, P. (2002). How Informative Are Value-at-Risk Disclosures? *The Accounting Review*, 77, 911-931. <https://doi.org/10.2308/accr.2002.77.4.911>
15. Khalid, A. M., & Hanif, M. N. (2005). Corporate Governance for Banks in Pakistan: Recent Developments and Regional Comparisons .
16. Klapper, L. F., & Love, I. (2002). Corporate Governance, Investor Protection and Performance in Emerging Markets. *SSRN Electronic Journal*, 10, 703-728. <https://doi.org/10.2139/ssrn.303979>
17. Konishi, M., & Yasuda, Y. (2004). Factors Affecting Bank Risk Taking: Evidence from Japan. *Journal of Banking & Finance*, 28, 215-232. [https://doi.org/10.1016/S0378-4266\(02\)00405-3](https://doi.org/10.1016/S0378-4266(02)00405-3)
18. La Porta, R., Lopez-de-Silanes, F., Shleifer, A., & Vishny, R. (2002). Investor Protection and Corporate Valuation. *The Journal of Finance*, 57, 1147-1170. <https://doi.org/10.1111/1540-6261.00457>
19. Llewellyn, D. T., & Sinha, R. (2000). Monitoring and Control of Banks: The Role of Regulation and Corporate Governance. *Corporate Governance in Banking and Finance*. McGraw-Hill.
20. Macey, J. R., & O'hara, M. (2003). The Corporate Governance of Banks. *Economic Policy Review*, 9, 91-107.
21. Mester, L. J. (1993). Efficiency in the Savings and Loan Industry. *Journal of Banking & Finance*, 17, 267-286. [https://doi.org/10.1016/0378-4266\(93\)90032-9](https://doi.org/10.1016/0378-4266(93)90032-9)
22. Nam, S. W. (2004). Corporate Governance of Banks: Review of Issues. *Work in Progress* .
23. Nishat, M., & Shaheen, R. (2007). Corporate Governance and Firm Performance in an Emerging Market—An Exploratory Analysis of Pakistan. *Corporate Ownership & Control*, 4, 216-225. <https://doi.org/10.22495/cocv4i2c1p6>
24. O'Hara, M. (1981). Property Rights and the Financial Firm. *The Journal of Law and Economics*, 24, 317-332. <https://doi.org/10.1086/466986>
25. Patrick, H. (2001, December). Corporate Governance, Ownership Structure and Financial Crisis: Experience of East Asian Countries. *KDIC International Financial Symposium*.
26. Shleifer, A., & Vishny, R. W. (1997). A Survey of Corporate Governance. *The Journal of Finance*, 52, 737-783. <https://doi.org/10.1111/j.1540-6261.1997.tb04820.x>
27. Tai, C. S. (2004). Can Bank Be a Source of Contagion during the 1997 Asian Crisis? *Journal of Banking & Finance*, 28, 399-421. [https://doi.org/10.1016/S0378-4266\(03\)00195-X](https://doi.org/10.1016/S0378-4266(03)00195-X)
28. Tandelilin, E., Kaaro, H., Mahadwartha, P. A., & Supriyatna, S. (2007). Corporate Governance, Risk Management and Bank Performance: Does Type of Ownership Matter. *EADN Individual Research Grant Project*, 34, 115-118.
29. Zingales, L. (1995). Insider Ownership and the Decision to Go Public. *The Review of Economic*

Studies, 62, 425-448. <https://doi.org/10.2307/2298036>

30. Cebenoyan, A. S., & Strahan, P. E. (2004). Risk Management, Capital Structure and Lending at Banks. *Journal of Banking & Finance*, 28, 19-43. [https://doi.org/10.1016/S0378-4266\(02\)00391-6](https://doi.org/10.1016/S0378-4266(02)00391-6)
31. Cheema, M., Shah, S. A., & Burki, A. A. (2006). *The Role of Mutual Funds and Non-Banking Financial Companies in Corporate Governance in Pakistan*. Lahore University of Management Sciences, Centre for Management and Economic Sciences.
32. Ciancanelli, P., & Reyes-Gonzalez, J. A. (2000). Corporate Governance in Banking: A Conceptual Framework. <https://doi.org/10.2139/ssrn.253714>
33. Claessens, S., & Fan, J. P. (2003). Corporate Governance in Asia: A Survey . <https://doi.org/10.2139/ssrn.386481>